



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: _____
Lep: _____
Nr. ifaq: _____
Broj-stranica: _____
Nr. pages: _____

DPK
05

Nr Prot: _____
Br Prot: _____
Prot No: **03-02/1852/18**
Data: _____
Datum: **09-07-2018**

DD/SH/TT/VE

DATË/A:	09.07.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKI-03-02-1570/18
PËR/ZA/TO:	z. Aleksander Lumezi Kryeprokuror Prokuroria e Shtetit
CC:	
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli Drejtor Agjencia Kundër Korrupsionit <i>Shqip.</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me dyshimet për konflikt interesi në ushtrimin e funksioneve publike

I nderuar Kryeprokuror i shtetit z. Lumezi,

Në mbështetje të Nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Nenit 21, paragrafi 1, nën paragrafët 1.5 dhe 1.7, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim përdoret edhe si L.P.K.I), Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim përdoret edhe si AKK) ka shqyrtuar kërkesën tuaj, rasti me nr. AKK-03-02-1570/18, që njëkohësisht ishte edhe interesim i palëve të treta, e që ndërlidhet me pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj në detyra tjera, si: Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës; Anëtar/Kryesues i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë; Anëtar i Bordit të Njësisë së Intelegjencës Financiare; Anëtar i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike; si dhe Kryetar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, të gjitha këto krahas funksionit tuaj primar të Kryeprokurorit të shtetit.

Agjencia Kundër Korrupsionit, në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, sipas Nenit 21, pika 1.5 *”ofron këshillim për zyrtarët të lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas këtij ligji pasi janë shteruar mjetet e brendshme në institucionet punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë;”*.

Po ashtu Agjencia Kundër Korrupsionit sipas Nenit 22, paragrafi 1, pika 1.5 të L.P.K.I., është e obliguar *“që të filloj procedurën për shqyrtimin e situatave të konfliktit të interesit edhe në bazë të lajmërimit të ndonjë personi tjetër apo lajmërimit anonim”*.

Agjencia në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në kuadër të përgjegjësiave të veta ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në përgjithësi (Neni 21, paragrafi 1.7). Në përputhje me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit, pas vlerësimit të rrethanave lidhur me rastin konkret ofron këtë:

OPINION

- I. **Nuk ka konflikt interesi** në ushtrimin e funksionit të Kryeprokurorit të shtetit dhe funksioneve: Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës; Anëtar/Kryesues i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë; Anëtar i Bordit Drejtues të Njesisë së Intelegjencës financiare; dhe Anëtar i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.
- II. **Nuk ka konflikt interesi faktik** të qenurit Kryetar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht ka lexuar kërkesën e Kryeprokurorit të shtetit për sqarim të kësaj çështje (DPK-03-02-1570/18), por njëkohësisht edhe kërkesën nga pala e tretë me pretendime për situatë të konfliktit të interesit që lidhen me këto funksione.

Agjencia kundër Korrupsionit ka nxjerr këtë konstatim si në këtë dispozitiv, duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.06/L-011), takimit zyrtar të zyrtarëve të Agjencisë me Kryeprokurorin e shtetit, informacioneve të siguruara nga Zyra e Kryeprokurorit dhe analizës së bazës tjetër ligjore në lidhje me këtë çështje.

I. Lidhur me këto çështje të ngritura dhe dilemave apo dyshime eventuale, dispozita kryesore që jep përgjigje në të gjitha angazhimet sipas pikës së parë në këtë dispozitiv, buron nga Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, konkretisht nga Neni 13 paragrafi 2, e cila shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”.

Pra, duke qenë në pozitën e Kryeprokurorit të shtetit, me ligje tjera përkatëse, shprehimisht është e paraparë që të jetë i përcaktuar edhe:

- **Për Anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës**, e përcakton Ligji Nr.03/L-224, Për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 5, Përbërja dhe Përzgjedhja e Anëtarëve të Këshillit. Paragrafi 2.1, Kryeprokurori i shtetit.
- **Për Anëtar të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë**, e përcakton Ligji Nr.05/L-095 Për Akademinë e Drejtësisë, Neni 8, paragrafi 1.1 dhe 1.1.1. në të cilin shprehimisht thuhet: “Anëtar ex officio të Këshillit Drejtues janë: Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i shteti. Ndërsa për Kryesues, me shumicë votash e ka zgjedh Këshilli pastaj.
- **Për Anëtar të Bordit të Njësisë së Intelgjencës financiare**, e përcakton Ligji Nr.05/L-096, Për Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, Neni 5 paragrafi 2, që flet për Anëtarët tjerë të Bordit, që do të jenë “ex officio”, ndër të cilët edhe Kryeprokurori i shtetit.
- **Për Anëtar të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike**, Ligji Nr.04/L-053, Për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Nenin 17 lidhur me Raportet, Përgjegjësitë e ndërsjella të Institucioneve dhe Akademisë përcakton pjesëmarrjen e institucioneve relevante në Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, si dhe mënyrën e funksionimit, organizimit si dhe qështjeve tjera procedurale të rregulluara me akt nënligjor, konkretisht me Rregulloren Nr. 06/2013, Për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, e cila është miratuar në Mbledhjen e 115 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr.03/115, me datë 13.02.2013. Në këtë rast, Rregullorja Nr.06/2013, Për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në Nenin 5 të saj precizon në mënyrë të qartë përbërjen e Bordit, dhe në pikën 1.1 të Nenit 5, përmendet edhe pozita e Kryeprokurorit të shtetit si pjesë përbërëse e Bordit.

II. Ndërsa, për Anëtar të Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës (Vendimi Nr.06-V-082, dt.15.03.2018), pas propozimit që vjen nga Ministri i Drejtësisë dhe aprovimit nga Kryeministri i Kosovës (Vendimi Nr.05/09, dt.20.10.2017).

Sipas Ligjit Nr.04/L-141, Për Provimin e Jurisprudencës, te përkufizimet, për shprehjen “Komision” shprehimisht thotë:

“Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës, është organ i pavarur profesional i cili organizon provime për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve juristëve të diplomuar të tjerë për të cilët për ushtrimin e profesionit kërkohet të ketë dhënë provimin e jurisprudencës”.

Pra, me këtë mund të konstatohet se të qenurit në përbërjen e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, nuk do të thotë se është njësoj sikur të jesh Anëtar i organit drejtues të ndërrmarjes në pronësi publike, apo i organeve drejtuese të institucioneve tjera publike, të përcaktuara në Nenin 13, paragrafi 2 i L.P.K.I.

Te Komisioni për dhënien e Provimit të Jurisprudencës bëhet fjalë për Komision të pavaruar profesional, për krijimin e të cilit duhet të respektohen procedurat e përmendura më lartë.

Nga ajo çfarë u tha si më lartë, Agjencia Kundër Korrupsionit konsideron se të gjitha angazhimet shtesë të Kryeprokurorit të shtetit nuk janë në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit.

Prandaj, nga e gjithë kjo situatë Agjencia Kundër Korrupsionit mund të jap **rekomandim** se, zyrtari i lartë, në këtë rast Kryeprokurori i shtetit, gjatë gjithë punës së tij, duhet të ketë vemendje në deklarimin e konfliktit të interesit “rast për rast” i cili mund të shfaqet eventualisht.

Konflikti i interesit “rast për rast” është i rregulluar me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I).

Zyrtarët e lartë publik që të parandalojnë konfliktin e interesit “rast për rast” duhet të bazohen në paragrafët e Nenit 17, si në vijim:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

2. *Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.*
3. *Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*
4. *Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.*
5. *Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.*

Agjencia kundër Korrupsionit ju falenderon për bashkëpunimin.

Me respekt!